



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 16, datë 05.04.2024

PËR

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“PARKU FOTOVOLTAIK BLUE 1”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË FIER

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve gjatë ndërtimit për objektin: “Parku Fotovoltaik Blue 1”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave vetëm për “Parkun fotovoltaik Blue 1”, bashkëlidhur Vendimit Nr. 22, datë 17.03.2021 “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Parku fotovoltaik Blue 1”, “Parku fotovoltaik Blue 2” dhe “Infrastruktura e lidhjes me rrjetin elektrik”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 26.03 / 2025